



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më  
29.03.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Rifat Deri (AKR-AA).

**Munguan:** Besnik Mujeci (LVV), Visare Gashi (PSD), Fiknete Bejta (AAK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK), dhe Baton Dushi (Nisma).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit.

Ai tha se jemi në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e thirrur me kërkesën e Kryetarit të Komunës, z. Shpend Ahmeti, me një pikë të rendit të ditës.

## Rendi i ditës:

### 1. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me pikën e rendit të ditës.

**Valbona Ahmeti- Makolli**, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, tha se shuma e mjeteve të bartura për vitin 2019 është 23,342,809.24 euro. Këto mjete janë destinuar në katër kategori: subvencione dhe transfere janë 6.811.462.49 euro, investime kapitale 16,801,346.75 euro dhe shpenzime komunale 45.000 euro. Shuma e mjeteve dhe projektet e kontraktura për vitin e kaluar janë paraqitur në tabelë.

**Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës, theksoi se ky nuk është buxhet i ri, andaj këtu nuk mund të futen projekte të reja. Pra, bartja ka të bëjë me projektet që kanë qenë vitin e kaluar. Mund të bëjmë ndonjë lëvizje ekzistuese në qoftë se ka mbetur ndonjë fond, por këto tash janë të adresuara, të kontraktuara. Këto mjete janë të bazuara në kontratat që i kemi, punët që janë duke vazhduar dhe në qoftë se vazhdojnë punimet sivjet, këto mjete duhet të jenë të kontraktuara. Sa i përket Pallatit të Rinisë dhe ish-Tjegullores, kemi harmonizuar me Ministrinë e Financave arsyetimin, i cili është i nevojshëm që Ministria e Financave ta lejojë transferin e këtyre mjeteve për këto dy ndërmarrje komunale. Po ashtu, disa ndryshime që mund t'i bëjmë, kanë të bëjnë me projektet e kontraktuara jo të buxhetuara. Disa klube sportive i kemi ndihmuar financiarisht, por gjithnjë në koordinim dhe harmonizim me Ministrinë e Financave, e cila na lejon këtë lëvizje nëpër kategori.

**Agim Gashi** u shpreh se para vetes kemi një dokument tjetër, që është i specifikuar sipas llojeve të projekteve që përmbledhin këtë sasi të bartjes, në vlerë 23 milionë e diçka euro. Ne më parë në këtë Kuvend kemi miratuar Raportin njëvjeçar të punës dhe i kemi kaluar, ku kërkesa e bartjes ka qene 25 milionë e diçka euro. Janë dy dokumente që nuk përputhen në mes vete dhe dallimi është 1 milion e 711.195 euro dhe duhet një sqarim me na dhënë këtu, sepse ky Kuvend nuk mund të miratojë dy dokumente që nuk përputhen në mes veti dhe që kanë të bëjnë me vlerat që ne i bartim për t'ia mundësuar qeverisë punën brenda këtij Kuvendi. Sa i përket radhitjes së projekteve, në emër të GP të LDK-së kërkoj që, brenda mundësive, të bëhet dallimi i projekteve të cilat janë proceduar në aspektin e prokurimit dhe janë lidhur kontratat, ose janë vlerësuar dhe s'mund të ndryshojmë dhe të shohim se a ka mbetje në ato kontrata të lidhura, sepse janë projektet që kanë filluar gjatë vitit të kaluar dhe ende s'kanë përfunduar dhe aty nuk mund të prekim. Këtu në pasqyrë, duke e krahasuar bartjen e vitit 2017 në 2018 shohim që ka bartje nga viti 2017, që janë tash në listë, siç është projekti i stadiumit në Hajvali etj. Po ashtu, kemi identifikuar disa gjëra, tash janë në procedurë të kryerjes së disa rrugëve në disa fshatra të Gollakut, mirëpo ka edhe disa lagje të kësaj zone që në buxhetin e planifikuar për vitin 2018 nuk janë paraparë projekte për rregullimin e infrastrukturës.



Besoj se ne kemi hapësirë për të korrigjuar, ta zëmë qoftë edhe provizore, në mënyrë që të kemi një harmoni në bartjen e buxhetit, për arsye se kështu qysh është, mendoj se nuk ka për të funksionuar komplet dhe prapë do të mbesin mjete të pashpenzuara. **Gëzim Mehmeti**, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, tha se sa i përket projekteve të parapara për zonat rurale, prej të gjitha bashkësive lokale në pjesët rurale që kanë bërë kërkesa, e kemi qar nga një projekt, do të thotë që edhe në fshatrat Mramor dhe Busi kemi investuar në rrugë. Kemi investuar edhe në fshatrat e tjera, si në Hajvali etj.

**Eman Rrahmani** shprehu mendimin se bartja e mjeteve për Pallatin e Rinisë dhe për ish-Tjegulloren, besoj se iu ka rekomanduar edhe Ministria e Financave, që këto mjete duhet me kaluar prej zërave buxhetorë në subvencione, dhe kjo nuk është duke ndodhur as tash, as nuk ka ndodhur herën e kaluar, d.m.th. kjo po bëhet vetëm në subvencione. Nuk tregohet sa është marrë prej këtij projekti që po kalon në këtë subvencion. Bartja që është bërë për te Pallati i Rinisë, do të thotë duhet shkruar në mënyrën e njëjtë, përveç që destinacioni nuk duhet shkruar drejt te Pallati i Rinisë apo te ish-Tjegullorja, por duhet shkruar te subvencioni. Mendoj se me këtë bartje që është bërë është shkëlur ligji dhe për këtë duhet dhënë llogari dikush, duke filluar prej kryetarit dhe të tjerëve. Këtë e kemi diskutuar dhe është vërtetuar që është shkëlur e ligjit ajo që është bërë në këtë punë. Unë e mbështes propozimin e parafolësit, që të shtyhet kjo mbledhje dhe të vijnë të gjitha këto me kode buxhetore, të cilat janë të kontraktuara dhe atëherë është shumë mirë që të bëhet kjo bartje sa më shpejt, të fillojnë punët dhe të mos ndodhë që edhe në vitin e ardhshëm të jetë dyfish vlera e bartjes në bazë të këtij intensiteti që keni filluar dhe po vazhdoni me punuar.

**Arbenita Murseli** u përqendrua kryesisht në subvencione dhe transfere në Sektorin e bujqësisë, duke thënë se është mirë që fermerët të stimulohen përmes fushatave sensibilizuese, në mënyrë që ata të ndër marrin hapin dhe të aplikojnë për subvencione të tilla. Me qenë se janë edhe ndër punëdhënësit kryesor, duhet t'u jepet fokus, sidomos zonave të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, e një shembull tipik e gjejmë në zonën e Gollakut. Projekti për trajtimin e qenve endacakë, ku janë në dispozicion 130.000 euro, nuk po realizohet, atëherë cila është arsyeja e mos realizimit të këtij projekti? Po ashtu, ka qenë kërkesë për kabinat e stacioneve të autobusëve, që janë shumë të domosdoshme në disa lagje të Prishtinës, projekte të cilat ende nuk po realizohen!

**Jeta Rafuna - Hasani** tha se një projekt për rrugën në Nishevc ka qenë i kontraktuar para 5 ose 6 vjetëve dhe faza e parë e punimeve është kryer, ndërsa faza e dytë, deri në 3 kilometra, ka mbetur e pa përfunduar, që e lidh fshatin Nishevc me një fshat të Podujevës. Pse nuk është paraparë ky projekt edhe me këtë bartje të buxhetit?

**Drilon Pireva** theksoi se për çdo aktivitet të prokurimit që bëhet e deri te kontraktimi ose nënshkrimi i kontratës, të gjitha ato procedura për projekte e tilla, në rast se s'janë kryer punët për një vit, mund të barten në vitin tjetër.

**Naime Osmani** tha se disa projekte në infrastrukturë që kanë qenë të parapara për realizim në fshatin Besi, kanë mbetur pa u përfunduar, si ajo në lagjen "Kallugjerica", pra dy familje të asaj lagje kanë mbetur pa u kyçur në rrjetin kryesor të kanalizimit. Po ashtu, problem i kanalizimit është edhe te "Next Marketi" dhe restorant "Rida", ku janë disa familje Dobratiqi edhe disa të tjerë që nuk janë të kyçur në kanalizim.

**Sami Boroci** u shpreh se në emër të grupit e mbështesim bartjen e buxhetit në vlerën e propozuar. Për mua si shqetësim mbetet vetëm vlera e bartjes, që mendoj se ndoshta nuk ishte dashur me pasur një vlerë kaq të madhe të bartjeve prej vitit në vit, mirëpo është krejt normale se çdo vit ka bartje të buxhetit.

Disa projekte, si p.sh. stadiumi i Hajvalisë, ka shkuar në mënyrën më të keqe të mundshme deri më tani. Si projekt ka ngecur dhe mendoj se ndoshta ekzekutivi do duhej trajtuar që të finalizohet sa më shpejt.

Për punët të cilat po bëhen në rindërtimin e rrugëve "Hollgen Petersen" dhe "Ulëza", e cila është një rrugë që e lidh pjesën prej Hajvalisë deri tek EULEX-i, rrugë e cila shkon deri te xhamia e Hajvalisë, kërkoj një sqarim nga drejtori i drejtorisë përkatëse lidhur me këtë projekt. Po ashtu, është më se i domosdoshëm edhe ndërtimi i një kolektori për grumbullimin e ujërave të zeza nga Pallati i Drejtësisë, pasi që në atë pjesë kanë një problem të jashtëzakonshëm me kundërmimin e madh që ndodh aty.

**Shefki Gashi** tha se duke pasur parasysh që ky dallimi në mes të aprovimit të kaluar për 25 milionë euro që ishin për bartje, edhe kjo që po barten 23 milionë, edhe për teprica që janë të projekteve të kontraktuara, kisha propozuar që brenda 2-3 orëve me e sanuar këtë gjendje, me ardhur në seancë dhe me aprovuar këtë bartje, që mos të ndalen projektet e mos të kenë pengesa juridiko - parlamentare për veprimin e mëtutjeshëm të ekzekutimit të programeve të projekteve të tyre. Ai kërkoj që ky propozim të hedhet në votim.

**Vlora Dumoshi** theksoi se ne sot jemi duke e diskutuar bartjen e buxhetit të pashpenzuar, që kjo flet në vete shumë dhe ka një emër dhe mbiemër, është një dështim i menaxhimit të projekteve, prandaj dhe ne po kërkojmë të dimë vlerën se sa mjete janë shpenzuar dhe sa janë të lira.

**Egzon Azemi** tha se janë disa projekte të cilat po ashtu kanë rëndësi për qytetarët, e që kanë qenë projekte që kanë nisur por nuk kanë përfunduar. Si shembull, në vitin 2017 është shtruar rruga në Matëçan, nga shkolla "Mitrush Kuteli" deri te restorant "Panorama", ndërsa rruga për Zllatar edhe pse është paraparë në projekt, sot e asaj dite ka mbetur e paprekur.

Po ashtu, edhe për projektin e rrethojave të varrezave të dëshmorëve në Marec, projekt i cili edhe përkundër insistimit tonë, deri më tani asnjë punë nuk ka filluar për realizimin e tij. Kërkoj sqarim nga drejtori përgjigjes se pse ky projekt nuk ka filluar ende.



**Nol Nushi** tha se para nesh e kemi një listë me kontrata të nënshkruara, pra ekzekutivi edhe po të donte, nuk guxon me gënjer për këto. Dihet se për çdo ditë Komuna e Prishtinës lavdërohet, përmendet, nderohet nga organizatat e ndryshme për transparencën e saj, sidomos me procesin e prokurimit. Kontratat janë të hapura, andaj dhe pajtohem me parafolësit të cilët kërkuan që raporti të ishte edhe më detal.

Nëse teprojnë mjete nga projekte, nuk do të thotë se ato mjete humbin, ato mbesin në Komunë, se ato janë prej të hyrave vetanake, prandaj nuk mundet një komunë që shpallet më transparente, me u akuzuar për mashtrim ose gënjeshtër apo diçka tjetër.

**Leutrim Retkoceri** tha se kjo bartje e mjeteve, e cila po na përsëritet po thujse çdo vit, është shqetësuese, sepse këto para po barten nga një vit në tjetrin, punët po zvarriten dhe qytetarët kanë nevojë për shumë projekte në lagjet e tyre dhe në tërë qytetin.

Përveç investimeve në projektet në infrastrukturë, kam ngritur disa çështje edhe kur ka qenë buxheti që është votuar, pra pse nuk po investohen më shumë para për projekte edhe për mbështetje të të rinjve të kryeqytetit, ku edhe ata kanë projekte, kanë ide inovative, munden me gjeneruar vende të reja të punës etj. Po ashtu, do të ishte shumë e nevojshme që të investohet në përmirësimin e higjienës në tualetet e shkollave publike të kryeqytetit, të cilat janë në një gjendje tmerruese. Në këtë material nuk po shihet se ka projekt të bartur për parandalimin e ndotjes së ajrit, që kemi folur shumë para një viti, pra edhe kjo është shqetësuese.

Këtu po shihet që janë 3.7 milionë euro të ndara si subvencion për Pallatin e Rinisë, por kishte qenë mirë edhe kryetari me na e dhënë një shpjegim se kur e ka marr ndërmarrjen Pallati i Rinisë, a ka pasur raport nga auditori se në çfarë gjendje po e merr, si po alokohen këto 3.7 milionë euro, borxhe të kujt janë ato, do duhej ta kishim edhe në një raport, në mënyrë që ta lehtësojmë procedurën e këtij Kuvendi. **Rifat Deri** tha se është e panevojshme që të diskutohet kaq gjatë për këtë pikë, sepse ne duhet vetëm të marrim vendim a po i lejojmë Kuvendit me i bartur mjetet apo nuk po i lejojmë. Këto janë mjetet të pashpenzuara, të cilat janë të kontraktuara, por nuk janë bërë pagesat e duhet me u bartur në vitin 2019. Ne po ashtu që të gjithë jemi të interesuar ta dimë se çka po ndodh në ndërmarrjen Pallati i Rinisë, por besoj se të gjitha problemet në këtë ndërmarrje do të eliminohen me rastin e lejimit të bartjes së këtyre mjeteve prej vitit 2018 në vitin 2019.

**Valbona Ajeti** kërkoi nga kryesuesi që propozimvendimi të hedhet në votim, sepse këto mjete janë të kontraktuara, kështu që mos të humbim kohë, të ecim përpara. **Gëzim Mehmeti**, drejtor, tha se të gjitha këto projekte për të cilat u diskutua, janë të kontraktuara.

Sa i përket projektit për ndërtimin e stadiumit në Hajvali, janë dy kontrata, dy faza.

Një fazë është "Ndërtimi i stadiumit të futbollit në fshatin Hajvali", që ka filluar në vitin 2014, që është e kontraktuar, me vlerë prej 76 mijë e 900 euro, pastaj e kemi fazën e dytë, ku janë të parapara 400 mijë e diçka euro, pra është vlerë e kontraktuar. Këtu i kemi dy kontrata me dy operatorë ekonomikë të ndryshëm. Një gjë që është vërejtur me operatorët ekonomikë, mendohet se operatorët ekonomik në Kosovë nuk kanë stabilitet të madh sa i përket financave. Prej vitit 1999, nuk ka ndodhur asnjëherë që projektet me u dërguar në prokurim në muajin mars, kështu që 46 projekte i kemi përfunduar, i kemi dërguar në mars, kjo nënkupton se është punuar në mënyrë sistematike që sivjet me u realizuar këto projekte.

Po ashtu, tash e kemi dërguar në prokurim edhe projektin e Tregut, që është këtu afër, që do të fillojmë shumë shpejt me implementimin e punimeve në treg, një projekt shumë madhor, i cili ka me qenë interesant për turistët të cilët e vizitojnë Prishtinën.

Ne mundemi me biseduar për mbetje të mjeteve dhe për këtë pajtohëm, por sa i përket kontratave, nuk ka askush mandat me bërë ndryshime. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, ky projekt do të vazhdojë, pra është një fazë tjetër. Ndërsa sa i përket projektit për fshatin Nishec, nuk është planifikuar për këtë vit, por mendojmë se në vitin e ardhshëm do të jetë në planifikim.

*Kryesuesi tha se kjo është seancë e jashtëzakonshme edhe nuk ka ndryshime në rend të ditës, sepse është kërkuar nga kryetari edhe si ditë, edhe si orar, edhe si temë, e do të hidhet në votim ashtu siç është propozuar.*

**Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019.**

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta**



Faqe 6 nga 6